



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJ
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

Informacion mbi aktivitetin e planifikuar në projektin:
“Interpretimi/përkthimi në realitetin virtual. Integrimi i teknologjisë në procesin e përkthimit”

**-Trajnimi dhe aftësimi i studentëve në fushën e përkthimit virtual-
organizuar nga Dr. MARSELA LIKAJ, datë 01.06.2023**

Në vijim të aktiviteteve të organizuara në kuadër të projektit *Interpretimi/përkthimi në realitetin virtual. Integrimi i teknologjisë në procesin e përkthimit. -Trajnimi dhe aftësimi i studentëve në fushën e përkthimit virtual-* si dhe mbështetur në analizën e pyetësorëve të organizuara nga grupi i punës së këtij projekti, më datë 01.06.2023 u organizua me studentët e programit të studimit *Master në përkthim-interpretim dhe Bachelor në përkthim-interpretim* trajnimi me temën “*Përkthimi automatik në fushën e letërsisë*”.

Trajnimi u realizua nga Dr. Marsela Likaj, e cila e ka fokus të punës së saj shkencore fushën e letërsisë dhe atë të përkthimit letrar. Trajnimi ishte me shumë interes për studentët dhe gjatë trajnimit pati diskutime interesante.

Trajnimi u fokusuan në këto çështje:

1. Njohuritë dhe përvoja në fushën e përkthimit letrar
2. Roli i teknologjive të reja dhe aplikacionet VR në përkthimin letrar. Qëllimi ishte rritja e vëmendjes së studentëve ndaj teknologjive të reja, si realiteti virtual dhe aplikacionet e tij në fushën e përkthimit letrar. Qëllimi është të vlerësohet interesimi dhe përgatitshmëria e studentëve për të eksploruar dhe përdorur këto teknologji në praktikën e tyre të përkthimit letrar.
3. Pritshmëritë në lidhje me trajnimin: Kjo çështje synoi të zbulojë pritshmëritë e studentëve në lidhje me trajnimin dhe përfshirjen e tyre në projektin e interpretimit në realitetin virtual.



